# GJYKATA PO SABOTON PUNËN TONE

Nga Xhavit Shala

Nëpërmjet kësaj interviste në "Gazeta Shqiptare" janë bere përpjekje që më fakte të informohet opinionin publik për demin që po i shkaktohet luftës ndaj krimit nga korrupsioni në sistemin e drejtësisë. Është synuar te përcillet një mesazh i qarte se pa një angazhim të gjithë strukturave dhe të agjencive që e kanë për detyrë të luftojnë krimin e të japin drejtësi, pa funksionimin e mirë të trekëndëshit polici-prokurori-gjykate, nuk mund te ketë arritje të qëndrueshme në luftën ndaj krimit, sidomos atij të organizuar. [1]

**Gazeta Shqiptare:** Zoti Shala, a keni pasur raste kur ju si polici keni kapur persona ne kërkim nga Prokuroria dhe Gjykata ka vendosur lirimin e tyre ?

**Xhavit Shala:** Ne kapim persona qe kërkohen nga Policia, nga Prokuroria, gjithashtu edhe persona te kërkuar me vendim gjykate. Kemi kapur nga te tre kategoritë e personave dhe kemi proceduar sipas normave ligjore. Nëse është vendim gjykate, behet menjëherë ekzekutimi i vendimit, nëse personi është i kërkuar nga Prokuroria, ne e shoqërojmë ne dhomat e paraburgimit dhe njoftojmë Prokurorinë. Është prokurori i çështjes ai qe vendos me tej për ecurinë e çështjes. Nëse ai është i kërkuar nga Policia, kryhen veprimet e duhura dhe njoftohet Prokuroria. Ka pasur raste qe këta persona janë liruar padrejtësisht nga gjykata.

**Gazeta Shqiptare:** Cili është opinioni juaj për kontradiktën tashme te vjetër Polici – Gjykate ?

**Xhavit Shala:** Ne kemi arrestuar persona te dokumentuar mire për veprën e tyre kriminale dhe Gjykata i ka liruar. Muajt e fundit te vitit 2000, janë arrestuar shume persona të implikuar ne veprimtari kriminale. Por, megjithe provat e paraqitura, ne Gjykate janë lënë te lire ne kundërshtim me ligjin, ose janë lënë me arrest shtëpie, apo me gjobe. Nga 15 vepra penale te dërguara ne Gjykata nga Policia nëpërmjet Prokurorisë, në muajt e fundit te vitit 2000, janë lënë te lire autorët e 12 veprave penale. Gjykata përpiqet te argumentoje tezen :"Ne jemi ata qe vendosim drejtësinë", pavarësisht se ata shkelin ligjin me te dyja këmbët. Rasti me i freskët, ai i gjykimit te Kudret Hoxhës, i cili kapet ne shtëpi me arme dhe drogë , e gjykatësi i çështjes Gazmend Bega e le atë te lire, duke e nxjerre nga burgu. Kush do ta dëgjonte këtë fakt, do te thotë se është një çmenduri. Nga zyra e antidrogës ka pasur shume raste operacionesh te suksesshme, por qe përpjekjet e tyre shkojnë dem, pasi Gjykata i liron. Po kështu nga shefi i krimeve jam informuar për raste tipike si ai i Leonidha Koçanit,i akuzuar për rrëmbim personi e trafik femrash, por Gjykata mjaftohet vetëm me arrest shtëpie. Me flagrante

[1] Intervista është botuar në "Gazeta Shqiptare" date 21.1.2001

është fakti qe këto janë disa figura krimi qe i përkasin krimit te organizuar dhe Gjykata ne vend qe te shtoje masën e dënimit, t'i japë dënimin ne kufijtë maksimale, ajo jep ne kufijtë minimale ose te shumtën e rasteve jashtë parashikimit, duke i kaluar me arrest shtëpie. Ne luftën e kundër krimit, sidomos atij te organizuar, nuk mund te lihet e vetme Policia dhe Prokuroria. Nëse nuk ekziston bashkëpunimi i trekëndëshit Polici-Prokurori-Gjykate, kjo pune do te jete e vështire.

**Gazeta Shqiptare:** Nuk jeni ankuar për këtë?

**Xhavit Shala:** Jo rrallë ne bëjmë ankese. Ne Ministrinë e Rendit, Ministrinë e Drejtësisë apo dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Po ju tregoj një rast te fundit. Jemi ankuar për një gjyqtar, i cili me vendim te KLD-se u shkarkua. Por kriminelin ai e nxori nga burgu. Ai kriminel mbeti i lire dhe përsëri mund te vrase një qytetar apo polic, si dhe të kryejë krime te tjera.

**Gazeta Shqiptare:** Ekzistojnë opinione se ju kapni me te dobëtit, ndërsa “te fortët” shëtisin te lire neper qytet. Mendimi juaj ... ?

**Xhavit Shala:** Përpara ligjit policia i ka njëlloj te gjithë. Ne kemi kapur edhe “te forte” dhe cilindo qe shkel ligjin. Për policinë e Fierit, nuk është fare problem kjo pune. Ka perënduar koha e “te fortëve” ne Shqipëri. S’ka rreth te Shqipërisë qe policia ka frike te kape “te fortët”

**Gazeta Shqiptare:** Përveç rasteve te ndjekjes penale gjate viteve 2000 te oficereve dhe policeve te inkriminuar, ka pasur raste te tjera te këtij lloji ?

Deri tani nuk kemi pasur raste te tilla, por sigurisht qe nuk do te hezitojmë për t'i ndjekur penalisht e arrestuar, qofshin ata dhe nga pjesëtaret e efektivit.

**Gazeta Shqiptare: Po l**ufta juaj kundër personave ne kërkim.

**Xhavit Shala:** Ne kemi filluar e ne vazhdimësi po japim dhe do japim goditje. Deri tani, pra për 20 ditët e 2001, kemi kapur 14 persona ne kërkim dhe nga këta persona mjaft te rrezikshëm qe akuzohen për grabitje me arme dhe jo për vepra penale te lehta. Me këto ritme do vazhdohet. Kane marre detyrën gjithë strukturat e policisë Qarkut Fier qe te jene vazhdimisht ne lufte për kapjen e personave në kërkim, autorë të veprave penale. Sepse lenia e lire e tyre përben rrezik potencial për rritjen e kriminalitetit. Gjithashtu ka filluar qysh ne Nëntor 2000 lufta kundër trafikut njerëzor, ku policia e Fierit ka qene e suksesshme. Shume shpejt do të shikoni se kjo pune do te behet me e organizuar dhe me një strategji të qartë.

Gazeta Shqiptare, 21 Janar 2001



RENDI | GAZETA SHQIPTARE E diel, 21 janar 2001 | AKTUALITET - 7

FIER/ *"Ne kemi arrestuar persona të dokumentuar mirë për veprën e tyre kriminale dhe Gjykata i ka liruar"*

**INTERVISTE/** Flet Xhavit Shala: "Ata që arrestojmë janë liruar ose gjobitur"

# "Gjykata saboton punën tonë"

## *Drejtori i Policisë së Fierit akuzon togat e zeza*

**FIER/ Policia: Ja ç'kemi bërë**

Për 20 ditë, 14 të kërkuar në pranga


WESTERN UNION | TRANSFERTE PARASH SM

Dërgesat më të shpejta të parave nga e gjithë bota

Tel: 04 234979

Gazeta “Koha Jone” 25 Prill 2001



KOHA JONE

www.kohajone.com

Kryeministri kërkon garanci në Grupin Parlamentar të PS-së për shkarkimin e tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë, të cilët favorizuan të akuzuarin Kudret Hoxha

# Trafikanti mes Metës dhe PS-së

Pazaret e Gjykatës së Lartë me Opozitën

Vdes në stërvitje ushtari i Gardës

Gazeta “Koha Jone” 25 Prill 2001

Koha Jonë E mërkurë, 25 prill 2001

Kryeministri kërkon garanci në Grupin Parlamentar të PS-së

# Trafikanti ka miq në Kryesinë e PS-së

**Një eksponent i kupolës së PS-së ka lidhje të vjetra me të akuzuarin si trafikant, fierakun Kudret Hoxha, të liruar dhe të favorizuar pikërisht nga gjyqtarët që kërkon të shkarkojë mocioni Meta.**

**TIRANË**-Maxhoranca socialiste në Kuvend duket se nuk është në një zë për shkarkimin e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Burime të sigurta të gazetës "KJ" tregojnë se një prej eksponentëve të kupolës së maxhorancës ka lidhje të vjetra me të akuzuarin si trafikant të liruar dhe të favorizuar pikërisht nga gjyqtarët që kërkon të shkarkojë mocioni Meta. Bile, sipas disa dëshmive të cilat mbërrijnë nga gjyqësori, ai edhe ka ndërhyrë në Gjykatën e Lartë për të shkuar tek ai vendim i tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë, gjë për të cilën nesër grupi parlamentar i PS-së vihet para një prove dinjiteti dhe transparence. Vendimi për shkarkimin e gjyqtarëve që bëhet nesër në Kuvend do të jetë i fshehtë, ndaj nuk dihet saktësisht se cili do të votojë, ashtu siç deklarojnë në grupin parlamentar apo në media. Nisur nga këto lidhje të vjetra e ndërhyrje në favor të tij nga një prej krerëve të PS-së (emri i të cilit mund të mësohet pasi të verifikohen edhe disa të dhëna emigrimi) thuhet se jo vetëm votat e opozitës dhe njerëzve të Gjinushit do të jenë kundër, por ndoshta edhe disa vota nga radhët e PS-së, përjashtuar këtu deputetin Sulë Kuqi, i cili tha dje: "Përderisa u dha urdhër dhe u hoqën kioskat e Parkut "Rinia", me siguri që do të shkulen edhe kioskat që kanë mbirë në mes të Gjykatës së Lartë". Për këtë arsye, kur mocioni nuk është krejt i sigurtë, kryeministrit Meta i është dashur të shkojë dje në mbledhjen e Grupit Parlamentar të PS-së, që si rrallëherë kishte të pranishëm pothuajse të gjithë deputetët. Mes tyre ishin sekretarët e selisë rozë dhe ministrat e kabinetit qeveritar. Mungesat ishin të justifikuara. Nano e Ruçi ishin në të njëjtën kohë në koktejlin e Gjinushit për dhjetëvjetorin e PSD-së, ndërsa Dade e Dokle ndodhen në Strazburg, etj. Para mbledhjes së Grupit parlamentar, kryeministri Meta u takua me kryetarin e Grupit, deputetin dhe kandidatin për kryeministër Arben Malaj, me sekretarët e PS-së dhe Ministrin e Shtetit, Legisi. Mocioni i propozuar nga një pjesë e anëtarëve të qeverisë dhe deputetë të Grupit të PS-së do të kalojë nesër për votim, ndaj kryeministri argumentoi para deputetëve pse është shtyrë të propozojë këtë mocion shkarkimi. Burimet nga mbledhja e grupit të PS-së tregojnë për "KJ" se Meta është shprehur se ka ardhur koha që shteti të veprojë ndaj segmenteve të caktuara të korruptuara të gjyqësorit shqiptar. Meta ka theksuar para deputetëve se trafiqet kanë dëmtuar imazhin e qeverisë që ai drejton. Kryeministri ka thënë se aksionet e ndërmarra nga qeveria për të luftuar trafiqet, korrupsionin dhe kontrabandën, e kanë nxjerrë shpeshherë bllof punën në këtë drejtim. "Luftë kundër trafiqeve, korrupsionit dhe kontrabandës në të gjithë sektorët", premtoi kryeministri.

Deputetët që kanë marrë fjalën e kanë mbështetur shefin e ekzekutivit në këtë iniciativë. Ka pasur zëra që i kanë cilësuar si pa kuptim sharjet dhe fyerjet ndaj Ministrit të Drejtësisë, Arben Imami në Konferencën Gjyqësore të drejtuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, Thimio Kondi, dy ditë më parë. Ndërsa, pas këtij debati, kryetari i grupit parlamentar tha: "Do të kërkoja edhe përgjegjësitë edhe angazhimet e gjithë deputetëve për domosdoshmërinë e funksionimit sa më të plotë dhe teknik të grupit parlamentar të PS-së deri në ditën e fundit të këtij sesioni. Jo thjesht për vëmendjen që media tregon ndaj nesh, por për detyrimet që ne kemi. Gjithashtu mësohet se në parlament nesër do të jenë edhe përfaqësues të ambasadave të huaja të akredituara në Tiranë, të cilët do të raportojnë pranë shefave të tyre për këtë duel të ekzekutivit e të parlamentit kundër tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë që kanë favorizuar një trafikant droge, gjë për të cilën në shtetet me demokraci të zhvilluar dënohet rreptësisht dhe maksimalisht. Ata do të presin të dëgjojnë edhe të dyshuarin socialist që ka mbështetur (ndofta pa dashje) Kudret Hoxhën, duke i sugje[illegible] një ish-deputeti të PS-së, i cili tashmë është anëtar i Gjykatës së Lartë, që të lirohet trafikanti, duke hedhur poshtë vendimin e Gjykatës së Apelit në Vlorë. Por më kryesorja është se kr[illegible] i PS-së Fatos Nano është sh[illegible]ur për mbështetje të mocionit Meta, pasi kështu do të tregojmë publikisht se jemi kundër kujdo që shkel ligjet, pavarësisht nga posti apo nga kontributi në PS. Para ligjit duhet të jemi të gjithë të barabartë. Pra me këtë mesazh lideri Nano ka dhënë votën e tij pro-Mocionit.

Megjithatë nesër PS-ja ka provën e drejtësisë për Drejtësinë e korruptuar.

**Re. Po**

Kërkesa e Meidanit mbërrin në Kuvend

**1 SHKURT**

Gjykata e Fierit liron nga salla e gjyqit Kudret Hoxhën, duke bërë të shpërthejë një nga skandalet më të mëdha të drejtësisë shqiptare. Në shtëpinë e Hoxhës, më 30 dhjetor 2000, policia gjen 2 kg heroinë, një person në kërkim për një vrasje, 2 automatikë pa leje dhe një sasi fishekësh të mbajtur gjithashtu pa leje. Pas këtij skandali, lirohen nga detyra për implikim në skandal zëvendësprokurorja e Fierit dhe dy gjyqtarë të gjykatës së Fierit, Arta Dano dhe Gazmir Bega, si dhe paralajmërohet për pushim nga puna gjyqtari i Fierit Dritan Devole. Hija e skandaleve mbulon thuajse të gjithë gjyqtarët e Fierit, por KLD mjaftohet në disa lirime dhe asnjë nga togat e zeza nuk ndiqet penalisht për shpërdorim detyre. Ndërkohë, për çështjen Hoxha, Kryeministri, Ilir Meta, i kërkon parlamentit heqjen e imunitetit të 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të dyshuar se janë implikuar, për ti hapur rrugë hetimeve, por Kuvendi hodh poshtë kërkesën e tij.

Gazeta “Koha Jone”, 24 Janar 2002

# Kronika

Beteja

Vrulli i drejtorit të Policisë së Fierit, Xhavit Shala, ndërpritet nga prokuroria e gjykata

## Tutorët e prostitutave fitojnë mbi shtetin

*Pesë muaj pas zbatimit të strategjisë anti-prostitucion, asnjë tutor i dënuar*



## Porti i Durrësit humbi nga sulmet në SHBA

## Nuk është faji i “Koha Jonë” kur akuzohen mjekët

## Reagimi i spitalit të Lushnjës